

2

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Skender Boshtrakaj nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7.1 dhe 6.2 të ndëshkuara me nenin 16 par.1 pika 1.2 dhe nenin 16 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199, dhe nenit 13 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë **04.11.2011** merr këtë:

## AKTVE N D I M

**I PANDEHURI:** **Skender Demë Boshtrakaj**, i lindur më 01.11.1962 në fshatin Rastavicë, punon në Ministrinë për Rini, Kulturë dhe sport në Prishtinë, me shkollim superior, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike,

### Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si zyrtar i lartë publik në pozitën e U.D. Udhëheqës i Zyrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, nuk ka deklaruar pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsion, me rastin e marrjes së detyrës me datë 11.06.2010 brenda afatit ligjor prej 60 ditësh,

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 7.1 e ndëshkuar me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik,

Sepse, si zyrtar i lartë publik në vendin e punës së lartshënuar, nuk ka bërë deklarin e rregullt të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion brenda afati ligjor deri më 31.03.2011,

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, andaj, për këto kundërvajtje i shqiptohet,

## D Ë N I M I

- Për kundërvajtje nga neni 7.1 e ndëshkuar me nenin 16 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik me gjobë në shumë prej **150 € (njëqindpesëdhjetë euro)**,

- Për kundërvajtje nganeni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, me gjobë në shumë prej **300 € (treqind euro)**

Në aplikim të nenit 13 të Ligjit mbi Kundërvajtjet i shqiptohet një dënim unik me gjobë në shumë totale prej **400 € (katërqind euro)**.



**Shumën totale të lartshënuar prej 400 €, i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Paga bëhet në ndonjë agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **26 ditë**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.**

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

## A r s y e t i m

**Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë**, i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën 01/3228.2011 me datë 19.07.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë i njëjti në Agjencinë kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës e as deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë deri më datën 31.03.2011.

REPUBLIKA E KO...		Agjencia Kundër Korrupsion	
			
Dep.		No. Regj.	
Dep.	<b>DP</b>	No. Akt.	<b>03-4662/11</b>
No. Hq.		No. Hq.	
Broj stranica	<b>01</b>	Data	<b>30.11.2011</b>
No. pages			

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë me kërkesë të AKK, se vërtetë ka qenë i njoftuar për obligimin ligjor të deklarimit të pasurisë, mirëpo përmes komunikimit elektronik dhe takimit personal me zyrtarë të AKK i njëjti kishte shfaqur mospajtimin e tij për çështjen e publikimit të deklarimit, ngase sipas tij të dhënat e zyrtarëve të lartë mund të administrohen nga AKK apo institucioni tjetër relevant, por nuk është e nevojshme të njëjtat të jenë publike për opinionin e gjërë. Për të konfirmuar thënien e vet, i pandehuri i prezantoi gjyqtarës edhe letrën me të cilën i ishte drejtuar me e-mail drejtorit të AKK lidhur me çështjen e deklarimit të pasurisë. Në vazhdim i pandehuri sqaron se kishte kërkuar nga zyrtarët e AKK që deklarimi i tij të mbetet në dispozicion të AKK por të mos publikohet, sepse i njëjti nuk është person i zgjedhur me votën e popullit, mirëpo zyrtarët e AKK nuk i kishin garantuar, duke i thënë se ligji i obligon të bëjnë publikimin e të dhënave të caktuara.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjyqtarja dëgjoi edhe përfaqësuesin e AKK, zyrtarin Agron Behrami sipas Autorizimit të datës 02.11.2011, në cilësi të dëshmitarit, i cili i prezantoi gjyqtarës Vendimin 1250/2010 të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Skender Boshtrakaj, duke sqaruar se zyrtari Boshtrakaj është në pozitën e U.D. nga viti 2010 dhe se i njëjti nuk ka respektuar afatin 60 ditor për deklarimin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës e as afatin për deklarimin e rregullt vjetor. Në vazhdim përfaqësuesi i parashtruesi të kërkesës thekson se zyrtarët e AKK i kanë sqaruar çka publikohet e çka nuk publikohet dhe se AKK bënë zbatimin e ligjit të aplikueshëm njëjtë për të gjithë.


Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, të dëshmitarit si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës e administrimit të gjitha provave veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, konstatoi se i pandehuri ka kryer kundërvajtjet të cilat i vihen në barrë me kërkesë, ngase çështja e deklarimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publik është dashur të respektohet ligjërisht nga të gjithë pa dallim, ndërsa çfarëdo propozimi, sugjerimi apo rekomandimi për ndryshime pozitive në cilëndo lëmi është i mirëseardhur, mirëpo asesi nuk e liron asnjë zyrtarë nga përgjegjësia dhe obligimi që takon me ligj. Andaj, gjyqtarja të pandehurin e shpalli përgjegjës dhe e dënoi me dënimin e paraparë ligjorë.

Gjatë shqyrtimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar masën e shkeljes sipas pozitës së zyrtarit të lartë publik si dhe personalitetin e tij, të njëjtit në aplikim të nenit 13 të LK ia shqiptoi dënimin unik me gjobë të precizuar si në dispozitiv, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e kundërvajtjeve të tilla apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
Nr. regj.24920/2011, datë 04.11.2011

Gjyqtarja  
Suzana Cerkini



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.